



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike  
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Investicija  
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

Nr. 01/08

Prishtinë, 18.05.2020

Ministrja e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, mbështetur në nenin 11 të Ligjit 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, në nenin 8.1.4 dhe pikat 20, 30 e 31 të shtojcës 7 të Rregullores së Qeverisë 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe në vendimet e Qeverisë 01/09 të 13 marsit 2020, 1/11 të 15 marsit 2020 dhe 01/24 të 8 prillit 2020, si dhe duke marrë parasysh vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë, urdhëresat MEPTI-NIS 01/01 të 12 marsit 2020, 01/02 dhe 01/03 të 17 marsit 2020, 01/04 të 20 marsit 2020, 01/05 të 23 marsit 2020 dhe 01/07 të 12 prillit 2020 dhe rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike me qëllim të luftimit dhe parandalimit të pandemisë COVID-19, nxjerr këtë:

**URDHËRESË**

**për mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike  
gjatë emergjencës së shëndetit publik**

1. Lejohen të operojnë komplekset e përbëra nga lokale që kanë qasje në mjedis të hapur dhe lidhen mes vete me hapësira të përbashkëta, të cilat përfshijnë oborrët, sheshet, pazaret dhe hapësirat e ngjashme.
2. Mbeten të mbyllura qendrat tregtare që operojnë në mjedis të mbyllur.
3. Operatori përgjegjës për kompleksin nga pika 1 duhet të marrë këto masa:
  - 3.1. të sigurojë se nuk do të ketë tollovi në hapësira të përbashkëta dhe në hyrje të kompleksit ose të lokaleve, duke kufizuar numrin e njerëzve që hyjnë në kompleks, duke shpërndarë turmat dhe duke marrë masa të tjera të nevojshme;
  - 3.2. të dezinfektojë hapësirat e përbashkëta të kompleksit çdo dy orë dhe të sigurojë se operatorët e lokaleve dezinfektojnë lokalet çdo dy orë;
  - 3.3. në çdo hyrje të kompleksit, të vërë aparat për të hetuar personat me temperaturë të ngritur;

- 3.4. t'u mundësojë dezinfektimin e duarve personave në hyrje të kompleksit dhe në pika të mjaftueshme në hapësirat e përbashkëta;
  - 3.5. sipas mundësisë, t'u shpërndajë dorëza dhe maska personave që nuk kanë;
  - 3.6. t'ua ndalojë hyrjen në kompleks personave që kanë temperaturë të ngritur, që nuk bartin dorëza dhe maska, që nuk pranojnë të dezinfektojnë duart, ose që nuk u binden masave të tjera; dhe
  - 3.7. të inkurajojë lokalet brenda kompleksit që të shmangin pagesat me para të gatshme, duke nxitur klientët (përmes zbritjeve ose formave të tjera) që të kryejnë pagesat elektronikisht.
4. Operatori përgjegjës për kompleksin nga pika 1 dhe operatorët e lokaleve në kompleks duhet të marrin të gjitha masat që kërkohen me vendimet e Qeverisë, vendimet dhe urdhëresat e ministrive përgjegjëse dhe me rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike lidhur me luftimin dhe parandalimin e pandemisë COVID-19.
  5. Nëse nuk ka operator të vetëm përgjegjës për kompleksin nga pika 1, përgjegjësia u bie bashkërisht dhe veç e veç operatorëve të lokaleve brenda kompleksit.
  6. Inspektorët komunalë në bashkërendim me inspektorët e MEPTINIS-it do të mbikëqyrin zbatimin e kësaj urdhërese.
  7. Mbeten në fuqi urdhëresat MEPTINIS 01/01-01/05 dhe 01/07, për aq sa nuk janë ndryshuar nga kjo urdhëresë ose vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë ose të organeve kompetente.
  8. Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjëherë.

**Rozeta HAJDARI**

*Rozeta Hajdari*

Ministre në detyrë



**U dërgohet:**

- Zyrës së Kryeministrit
- Zëvendëskryeministrit
- të gjithë ministrave (ministrive)
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë
- Inspektoratit i Tregut
- Inspektoratit i Punës
- inspektorateve komunale
- Departamentit Ligjor
- Arkivit të Ministrisë